



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN
PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 666, DATË
10.10.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT
FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE DHE
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE E TË
PAGESAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE”, I NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, ka për qëllim të qartësojë procedurat e dhënies së bursave të nxënësve përfitues të kuotave financiare të ushqimit në mensa e konvikte, si dhe të përfshijë mundësinë e ofrimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të shërbimit të ushqimit në institucionet e arsimit parauniversitar të arsimit bazë.

Projektakti merr parasysh ndikimin në mirëqenien dhe zhvillimin social-emocional të nxënësve, përshtatshmërinë me kontekstin shqiptar dhe mundësitë e zbatimit në raport me infrastrukturën ekzistuese, numrin e mësuesve dhe stafit arsimor, ndryshimet demografike dhe burimet financiare të disponueshme.

Vendosja e kriterëve nga Këshilli Bashkiak për shpërndarjen e bursave siguron një proces më të drejtë dhe transparent kur numri i bursave është më i vogël se numri i

nxënësve që plotësojnë kushtet, pasi shpërblimi bazohet në rregulla të qarta dhe të miratuara nga institucionet vendore.

Një tjetër arsye e rëndësishme e propozimit të këtij projektvendimi është përcaktimi i të drejtës së njësive të vetëqeverisjes vendore që nëse kanë mundësi financiare të ofrojnë shërbim ushqimi në institucionet e arsimit bazë që janë në territorin që ato mbulojnë. Në këtë kuadër propozohet, që shërbimi të ofrohet nga njësitet e vetëqeverisjes vendore me miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, garantohet koordinimi ndërmjet pushtetit vendor dhe atij qendror dhe në ofrimin e këtij shërbimi të zbatohen në mënyrë të rregullt, të kontrolluar dhe në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave të miratuar me vendimin nr. 62/2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”, ku në shtyllën III parashikohet synimi për ngritjen e arsimit shqiptar në lartësinë e standardeve evropiane, duke e bërë shkollën urën e së ardhmes ku çdo fëmijë dhe i ri gjen mundësi për t’u rritur, për t’u formuar dhe për të qenë një qytetar dinjitoz i Evropës.

Ky projektakt është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030, e miratuar me vendimin nr. 88, datë 22.2.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030” në funksion të objektivit për zhvillimin e qëndrueshëm, ku përparësi i jepet rritjes së cilësisë së sektorit të arsimit dhe shkencës.

Projektvendimi është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Arsimit për t’u miratuar në vitin 2026, në zbatim të vendimit nr. 812, datë 26.12.2025, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË DHE EFEKTET E PRITSHME

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

Ky projektakt propozohet në kuadër të nevojës për përmirësime të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar me qëllim rritjen e qartësisë së dispozitave, unifikimin e zbatimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe harmonizimin e mbështetjes sociale për nxënësit me standardet e Bashkimit Europian. Në tre vitet e fundit, nga zbatimi i vendimit janë evidentuar problematika të rëndësishme në nivel operacional, ekonomik dhe administrativ, të cilat kërkojnë adresim për të siguruar funksionimin efektiv të mekanizmit të bursave dhe kuotave ushqimore.

Së pari, tre bashkitë më të mëdha të vendit Tirana, Durrësi dhe Elbasani i janë drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Arsimit me kërkesa për ndryshimin e dispozitave të vendimit në fuqi, lidhur me zbatimin e disa pikave të vendimit duke i konsideruar të paqarta dhe që lejojnë interpretime të ndryshme dhe sjellin vështirësi të konsiderueshme gjatë procesit të identifikimit të përfituesve, miratimit të bursave dhe menaxhimit financiar. Duke qenë se këto tre bashki mbulojnë përqindjen më të lartë të popullsisë shkollore dhe të nxënësve konviktorë, kërkesat e tyre reflektojnë një nevojë reale për ndryshim në nivel kombëtar.

Gjatë viteve të zbatimit të këtij vendimi është konstatuar se një pjesë e njësisve të vetëqeverisjes vendore nuk e kanë zbatuar atë në mënyrë rigoroze. Në disa raste, bashkitë kanë përcjellë vendimet e miratimit të bursave me vonesë, kanë marrë vendime jashtë afateve të përcaktuara dhe, në disa situata, kanë tejkaluar kompetencat e tyre institucionale. Gjithashtu, është vënë re se kërkesat për fonde janë paraqitur në fund të vitit shkollor, duke krijuar vonesa në procesin e financimit dhe duke treguar se bursa nuk është dhënë sipas parashikimit “çdo muaj”, siç përcaktohet në VKM.

Këto mangësi pasqyrojnë mungesën e respektimit të rregullave të raportimit, të afateve administrative dhe të procedurave të detyrueshme të përcaktuara në vendim. Si rezultat, janë krijuar vonesa në miratimin e bursave, trajtim i pabarabartë i nxënësve ndërmjet bashkive të ndryshme dhe mungesë uniformiteti në administrimin e fondeve publike.

Gjithashtu është identifikuar se për trajtimin e bursave për nxënësit e klasave të 10 ta, nuk është e qartë se cila njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për miratimin e bursës në rastet kur vendbanimi i përhershëm i nxënësit dhe shkolla ku

ai ndjek mësimet ndodhen në territore të ndryshme. Kjo ka sjellë vonesa të konsiderueshme dhe pasiguri institucionale në zbatimin e vendimit.

Gjithashtu harmonizimi i VKM së me praktikat e Bashkimit Europian është një element thelbësor. Standardet europiane kërkojnë indeksim automatik të përfitimeve financiare, vendosjen e standardeve minimale të detyrueshme për ushqimin dhe shërbimet sociale, rritjen e mbështetjes për nxënësit vulnerabël, mekanizma të fortë transparence dhe monitorimi, si dhe pjesëmarrjen e aktorëve lokalë në zbatim të unifikuar. Ndryshimet e propozuara sjellin sistemin shqiptar më pranë këtyre standardeve, duke përmirësuar efikasitetin dhe llogaridhënien.

Projektvendimi propozohet në zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili përcakton se kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Nëpërmjet projektvendimit propozohet të plotësohet procedurat e akordimit të njëjës prej formave të përkujdesjes nga shteti, konkretisht për formën e bursave për nxënësit, si dhe të shtohet një formë e re e përkujdesjes nga shteti ofrimi i shërbimit të ushqimit nëpërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për arsimin profesional projektakti propozohet në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, i cili përcakton se bursa është financimi monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një nxënësi për arritjet mësimore të tij ose sipas kriterëve të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Llojet e bursave janë: bursat e studimit për nxënësit me arritje mësimore, bursat e studimit për nxënësit që ndjekin drejtime profesionale që janë prioritet kombëtar ose vendor, bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë. Masa, kriteret e përfitim dhe procedurat e dhënies së bursave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Lidhur me plotësimin e procedurës së dhënies së bursave ky projektvendim propozohet edhe në kuadër të trajtimit të disa rasteve nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i cili ka trajtuar disa ankesa të cilat lidhen me procedurën e ndjekur nga ana e bashkive për trajtimin me bursë, bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c, të VKM nr. nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim e bursave

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimin parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Komisioneri ka konstatuar diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkive, për rastet e fëmijëve të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe Bashkive ju është kërkuar të marrin masa efektive, për trajtimin me bursë, bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c, të VKM nr. nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar. Me qëllim për të shmangur situata të tjera të ngjashme, si në rastin konkret, është rekomanduar që Bashkitë, të marrin masa paraprake efektive, për rregullimin e situatave të tilla.

Gjithashtu, në vijim të kërkesës së Bashkisë së Tiranës të depozituar nëpërmjet shkresës me nr. 5114 prot., datë 05.02.2026, protokolluar në Ministrinë e Arsimit me nr. 1072 prot., datë 05.02.2026 nëpërmjet të cilës ka kërkuar nga MA në cilësinë e organit kompetent, shqyrtimin dhe identifikimin e alternativave ligjore të mundshme, përmes të cilave Bashkisë Tiranë, mund t’i njihet në mënyrë të ligjshme kompetenca për të bashkëpunuar në lidhje me zbatimin e projektit “Pilotimi i programit passhkolllor” duke ofruar ushqimin për nxënësit e klasave 1-5, në shkollat nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në institucionet arsimore parauniversitare.

Programi “Pas Shkolle” synon të ofrojë mbështetje shtesë për nxënësit përmes aktiviteteve arsimore, kulturore dhe sportive pas përfundimit të orarit mësimor. Ky model rrit kohën që nxënësit kalojnë në ambientet e shkollës dhe kërkon masa mbështetëse që garantojnë mirëqenien dhe përqendrimin e tyre gjatë gjithë ditës. Në këtë kuadër, ofrimi i ushqimit në shkollë konsiderohet një element kyç për funksionimin efektiv të këtij programi.

1. Mbështetje për modelin e shkollës me kohë të zgjatur

Sigurimi i ushqimit në shkollë mbështet qëndrimin e zgjatur të nxënësve në institucion, duke garantuar energjinë dhe mirëqenien fizike të nevojshme për pjesëmarrje aktive në aktivitetet e programit “Pas Shkolle”.

2. Përmirësimi i rezultateve në të nxënë

Ushqyerja e rregullt dhe e balancuar ndikon drejtpërdrejt në përqendrimin, memorien dhe performancën akademike të nxënësve. Integrimi i ushqimit me

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

aktivitetet mbështetëse pas mësimit mund të rrisë efektivitetin e ndërhyrjeve arsimore dhe të përmirësojë rezultatet në të nxënë.

3. Promovimi i barazisë dhe përfshirjes sociale

Programi i ushqimit në shkolla ndihmon në reduktimin e pabarazive sociale, duke siguruar që të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga familje me më pak mundësi ekonomike, të kenë akses në një vakt të shëndetshëm gjatë qëndrimit të zgjatur në shkollë.

4. Rritja e pjesëmarrjes në programin “Pas Shkolle”

Ofrimi i ushqimit në shkollë rrit motivimin e nxënësve dhe besimin e prindërve për pjesëmarrjen në aktivitetet pas mësimit, duke kontribuar në rritjen e përfshirjes dhe qëndrueshmërisë së programit.

5. Promovimi i shëndetit dhe edukimit për ushqyerje të shëndetshme

Programi i ushqimit në shkolla krijon mundësi për edukim praktik mbi ushqyerjen e shëndetshme dhe stilin e jetesës, duke kontribuar në zhvillimin e zakoneve të mira ushqimore dhe në mirëqenien afatgjatë të nxënësve.

6. Përputhja me praktikat dhe rekomandimet ndërkombëtare

Në shumë vende europiane dhe në programe të mbështetura nga organizata ndërkombëtare, ushqimi në shkolla është pjesë integrale e programeve të qëndrimit të zgjatur në shkollë, pasi konsiderohet një faktor i rëndësishëm për suksesin e tyre.

Ky përcaktim është i nevojshëm sepse u mundëson njësitë të vetëqeverisjes vendore të kontribuojnë drejtpërdrejt në mirëqenien dhe zhvillimin e nxënësve në institucionet arsimore parauniversitare. Ofrimi i shërbimit të ushqimit në shkolla lidhet ngushtë me përmirësimin e shëndetit, përqendrimit dhe performancës së nxënësve në procesin mësimor. Një ushqyerje e rregullt dhe e kontrolluar sipas standardeve përkatëse ndikon pozitivisht në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijëve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave propozohet bazuar në nenin 100 të Kushtetutës, nenin 19, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, nenin 5 të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, nenin 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, nenin 6 të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, nenin 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, nenin 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenin 12, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS E BE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*.

VI. PËRMbledhje SHpjeguese E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi “Për disa shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar përbëhet nga 2 (dy) pika, si më poshtë:

Në pikën 1 të projektvendimit parashikohet se në vendimin në fuqi bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Nëpërmjet shkronjës “a” të pikës 1 të projektvendimit, parashikohet se në shkronjën “a” të pikës 2.1 togfjalëshi “dhe që akomodohen në konvikte publike”, shfuqizohet.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

Nëpërmjet shkronjës “b” të pikës 1 të projektvendimit, parashikohet se në pikën 3 pas fjalëve “*kategorive të mësipërme*” shtohen fjalët “*në arsimin e përgjithshëm*” .

Nëpërmjet shkronjës “c” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet se pas pikës 3 shtohet pika 3/1 që përcakton se nxënësit në arsimin profesional humbasin të drejtën e përfitimit të bursës vetëm në rast përsëritjeje të vitit shkollor .

Nëpërmjet shkronjës “d” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet se pas pikës 8 shtohet pika 8/1 që përcakton se në rastet kur numri i nxënësve që ndjekin arsimin e përgjithshëm që plotësojnë kriteret për përfitimin e bursës është më i lartë se mundësitë e financimit të miratuara për atë vit shkollor dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të mbulojë me fondet e veta mbështetjen për të gjithë nxënësit që plotësojnë kriteret, njësia e vetëqeverisjes vendore, me vendim të këshillit bashkiak, përcakton rregullat për shpërndarjen e bursave, sipas kategorive të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

Nëpërmjet shkronjës “e” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet ndryshimin i pikës 12 se për të gjithë nxënësit/prindërit paraqesin kërkesat për përfitimin e burës pranë drejtorive të institucioneve arsimore, të cilat dokumentojnë me procesverbal pranimin e tyre dhe një kopje e procesverbalit i jepet kërkuesit. Drejtoritë e institucioneve arsimore, për nxënësit që regjistrohen për herë në klasën e 10, të cilët përfitojnë bursë sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi, i dërgojnë zyrtarisht kërkesat për miratimin e bursës në njësitë e vetëqeverisjes vendore të vendbanimit të përhershëm të nxënësit. Për nxënësit e klasave të tjerë që kanë përfituar më parë bursa depozitojnë dokumentacionin për vijimin e përmbushjes së kriterëve.

Nëpërmjet shkronjës “f” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet se pas pikës 14/1 shtohet pika 14/2 që përcakton se për nxënësit e klasave të 10-ta, vendimet e këshillave bashkiakë për dhënien e bursave përcillen nga njësia e vetëqeverisjes vendore e vendbanimit tek njësia e vetëqeverisjes vendore ku ndodhet institucioni arsimor që ndjek nxënësi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 14.

Nëpërmjet shkronjës “g” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet se pas pikës 15 shtohet pika 15/1 që përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore dorëzojnë kërkesat për fondet e bursave brenda muajit shkurt. Për kërkesat e dorëzuara jashtë këtij afati, bursat mbuloohen me fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Nëpërmjet shkronjës “h” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet se pas pikës 22 shtohet pika 22/1 që përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore, me fondet e tyre buxhetore apo transfertës nga buxheti i shtetit, për institucionet arsimore parauniversitare publike në territorin që mbulojnë, mund të ofrojnë shërbimin e ushqimit për nxënësit, në përputhje me standardet dhe rregullat e miratuara nga autoritetet përgjegjëse për ushqimin.

Nëpërmjet shkronjës “i” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet ndryshimi i pikës 23 që përcakton se fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve të bursave administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave dhe konvikteve ku nxënësit ndjekin mësimet. Pagesa mujore e bursës bëhet si më poshtë vijon:

- a) Nxënësit që jetojnë në konvikt përfitojnë bursa në formën e kuotës ushqimore mujore, sipas pasqyrës nr. 3. Masa e bursës përlllogaritet si prodhim i kuotës ushqimore me dite qëndrimin në konvikt, për jo më shumë se 10 muaj kalendarik, në proporcion me ditë qëndrimin në konvikt.
- b) Nxënësit që nuk jetojnë në konvikt dhe që plotësojnë kriteret për bursë, përfitojnë vlerën e plotë të bursës mujore, e cila u paguhet pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare të prindit/prindërve ose përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësit çdo muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës. Masa e bursës për këtë kategori jepet në pasqyrën nr. 2, për arsimin e parauniversitar dhe 2.1 për arsimin profesional bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Nëpërmjet shkronjës “j” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet se pas pikës 30 shtohet pika 30/1 që përcakton se duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 kuota mujore e bursës për të gjithë nxënësit dhe vlerat e shpenzimeve vetjake për nxënësit që jetojnë në konvikt, sipas pasqyrave bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, indeksohen automatikisht çdo vit sipas indeksit të çmimeve të publikuar nga INSTAT. Bursa paguhet për të gjithë nxënësit që plotësojnë kriteret e këtij vendimi.

Nëpërmjet shkronjës “k” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet ndryshimi i pikës 29 që përcakton se ministria përgjegjëse për arsimin profesional jep në total jo më pak se 5 000 (pesë mijë) bursa në vit për nxënësit e arsimit profesional, nga të

cilat 2 500 (dy mijë e pesëqind) bursa janë të dedikuara për hyrjet e reja në shkollat profesionale të sistemit arsimor publik.

Nëpërmjet shkronjës “l” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet ndryshimi i pikës 33 që përcakton se vendimet e këshillave të njësive të vetëqeverisjes vendore, në raste të veçanta, mund të miratohen përtej këtij afati, por jo më vonë se muaji shkurt. Vendimet e këshillave të njësive të vetëqeverisjes vendore përtej këtij afati përballohen me fondet e tyre.

Nëpërmjet shkronjës “m” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet se pasqyrat nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me pasqyrat nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Nëpërmjet shkronjës “n” të pikës 1 të projektvendimit parashikohet se pas pasqyrës nr. 2, shtohet pasqyra 2/1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, institucionet e sistemit arsimor parauniversitar, si dhe ofruesit e arsimit të mesëm profesional publik.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Për hartimin e këtij projektvendimi ka kontribuar grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 8, datë 13.01.2026, të Ministrit të Arsimit “Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektakteve në zbatim të programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2026”, si dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për fushën e arsimit profesional.

Projektvendimi dërgohet për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet te Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe te

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor bazuar në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016 “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, pasi projektvendimi ngarkon drejtpërdrejtë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu, me shkresë projektvendimi dhe praktika shoqëruese dërgohen për mendim edhe pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Për hartimin e këtij projektvendimi ka kontribuar grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 8, datë 13.01.2026, të Ministrit të Arsimit “Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektakteve në zbatim të programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2026”.

Projektvendimi dërgohet për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet te Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor nëpërmjet sistemit e-aktet.

Me shkresë projektvendimi dhe praktika shoqëruese dërgohen për mendim pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore pranë Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, bazuar në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016 “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, pasi projektvendimi ngarkon drejtpërdrejtë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u shpreh me shkresën nr. 536/1 prot., datë 25.03.2026, si më poshtë:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë shqyrtimit të ankesave' të ardhura nga prindërit e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, rezulton se fëmijët e tyre janë përjashtuar nga përfitimi i bursave të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike.

Në përfundim të trajtimit të tyre, në 42 raste, Komisioneri konstatoi se fëmijët e subjekteve ankues, janë diskriminuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke dështuar të trajtohen me bursa, referuar parashikimeve të VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Në analizë të rasteve të trajtuara nga Komisioneri, u evidentuan problematikat si më poshtë vijon:

- mungesa e një akt administrativ ku të ishin përcaktuar qartë kriteret dhe dokumentacioni përkatës për përfitimin e bursave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar;
- mungesa e një procedure të qartë për trajtimin me bursa ku aplikantët të pajiseshin me një dokument, përmes së cilit të vërtetohej fakti i aplikimit, dorëzimit të dokumentacionit përkatës dhe kërkesa për përfitimin nga kriteri specifik sipas VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar;
- më dokumentacionin e kërkuar aplikuesve, si në rastet kur ata trajtoheshin me ndihmë ekonomike, pagesë paaftësie apo kishin statusin e jetimit, nga ana e njësisive të vetëqeverisjes vendore, është kërkuar edhe dokumentacion që disponohet nga institucionet vartëse të tyre, dhe në këto raste, mosdorëzimi i këtyre dokumenteve nga aplikuesit ka rezultuar në përjashtimin e aplikimeve për bursë;
- kërkesa e lidhur me dokumentacionin që duhet dorëzuar nga aplikantët sipas kritereve të pikës 2.1/c, të VKM-së sipërcituar, konkretisht të vërtetimit nga tatimet që karnuk ka biznes për çdo person madhor të familjes, të cilin e dispononin njësitë e vetëqeverisjes vendore, në dosjet e personave që përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike, u konstatua kërkesë e tepërt dhe e panevojshme duke qenë se administrohet prej tyre, si dhe krijonte për aplikantët një barrë të tepërt,
- nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ishte interpretuar në mënyrë të gabuar pika 2.1, shkronja c), të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, duke trajtuar me bursë nxënësit në pamundësi financiare, pa ndihmë ekonomike dhe me

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

prindër të papunë. VKM-ja përcakton shprehimisht se: “.... përfitojnë bursë...) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare...” Pra, kushti kumulativ dhe cilësimet: pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë, janë togfjalësha të shtuar nga ana e njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe që nuk citohen në pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së. VKM-ja nr. 666, datë 10.10.2019 e lidh përfitimin e bursës me qenien e nxënësit, fëmijë i familjes në nevojë. në pamundësi financiare.

- në disa çështje të paraqitura në fund të 2024, të cilat më pas u zgjidhën, u konstatua problematika se institucionet arsimore, të cilat pretenduan se ishin udhëzuar nga njësitë evetëqeverisjes vendore, nuk pranonin aplikimet dokumentacionin në rast se familjet trajtoheshin me ndihmë ekonomike.
- gjatë vitit 2022, Komisioneri ka rekomanduar Këshillin e Ministrave të marrë masa, për rishikimin e VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, duke shtuar trajtimin me bursë pa kushte shtesë, të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, pa vendosur si kusht kumulativ, braktisjen shkollore.
- një ndër problematikat kryesore të evidentuara gjatë trajtimit të çështjeve, konstatohet fakti që numri i nxënësve që kanë plotësuar kriteret për përfitimin e bursave ka qenë më i lartë se mundësitë financiare të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe fondet e transferuara nga ministria përkatëse.

Për sa më lartë, duke ju referuar problematikave të konstatuara më parë dhe për sa është parashikuar në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, është evidentuar se drejtoritë e shkollave nuk duhet të kenë rol vendimmarrës në pranimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kërkuar aplikuesve, por ato duhet të pranojnë dhe të mbajnë një procesverbal, duke cilësuar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikantët dhe më pas përcjelljen e tij në njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

Në këtë kuptim, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të jenë ato të cilat kanë rolin vendimmarrës nëpërmjet organeve përkatëse, për shqyrtimin e dokumentacionit dhe analizimin e tij, referuar kritereve të vendosura. Gjithashtu, theksojmë se në kuadër të transparencës, një kopje e procesverbalit të mbajtur nga ana e drejtorive të shkollave t'i vihet në dispozicion aplikuesve në momentin e dorëzimit të dokumentacionit përfundimtar.

MA informon se ky sugjerim është marrë në konsideratë duke shtuar pikën 7/1 e cila parashikon se: “7/1 Kërkesat për përfitimin e burës bëhen pranë institucioneve arsimore, të cilat dokumentojnë me procesverbal pranimin e tyre dhe i depozitojnë ato pranë NJVV. Një kopje e procesverbalit i jepet kërkuarit.”

Në analizë për sa është përmendur me sipër, përveç ndryshimeve të reflektuara në këtë projekt-vendim, Komisioneri thekson nevojën e disa ndryshimeve në VKM Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- rishikimin e pikës 2.1, germa c), ku citohet se: “Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:...c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë”, duke shtuar trajtimin me bursë pa kushte shtesë, të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, pa vendosur si kusht kumulativ, braktisjen shkollore apo mosndjekjen e arsimit bazë.

Ky sugjerim nuk është marrë në konsideratë pasi ky instrument i mbështetjes financiare për nxënësit ka për qëllim identifikimin e rrezikut real të braktisjes shkollore prandaj është kusht frekuentimi i procesit mësimor. Nëse i referohemi këtij propozimi do të mbështeteshin nxënësit edhe kur nuk ndjekin procesin mësimor. Në këtë kontekst ekziston rreziku që fondet të shpërndahen

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

jo në përputhje me politikën e mbështetjes së arsimit por të individit. Kjo VKM ka për qëllim të mbështesë arsimimin e nxënësve, mbështetja ekonomike realizohet nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe mirëqenien sociale.

- rishikimin e pikës 4, ku parashikohet se: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar”, duke e mos vendosur si kusht frekuentimin e procesit mësimor për përfitimin e bursave.

Ky sugjerim nuk mund të merret në konsideratë sipas argumenteve të dhënë më sipër, si dhe në rastet kur nuk frekuentohet procesi mësimor, nxënësi është paklasifikueshëm në fund të vitit shkollor. Politika arsimore e ofrimit të bursave për këtë kategori nxënësish synon që ndjekë procesin mësimor dhe kushti i frekuentimit garanton përfshirjen e tyre në shkollë.

- të parashikohet që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore të marrë masa për hartimin e një akti administrativ ku të përcaktohen qartë kriteret dhe dokumentacioni përkatës për përfitimin e bursave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar:

Ky sugjerim vlerësojmë se është i reflektuar me propozimet e projektvendimit ku parashikohet shtimi i pikës 8/1 duke përcaktuar se në rastet kur numri i nxënësve që plotësojnë kriteret për përfitimin e bursës është më i lartë se mundësitë e financimit të miratuara për atë vit shkollor dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të mbulojë me fondet e veta mbështetjen për të gjithë nxënësit që plotësojnë kriteret, njësia e vetëqeverisjes vendore, me vendim të këshillit bashkiak, përcakton kriteret e përparësisë për shpërndarjen e bursave, sipas kategorive të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

- të parashikohet një mekanizëm i qartë buxhetimi si dhe përgjegjësitë konkrete midis pushtetit qendror dhe vendor.

Ky sugjerim është reflektuar në tërësi në projektvendim, duke përcaktuar se në rast kur NJVV nuk respektojnë detyrimet e tyre, përballojnë nga buxheti i tyre kostot e bursave për nxënësit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi parashikon ndryshimet e mëposhtme me efekt të drejtpërdrejtë financiar:

- a) Heqja e kushtit të akomodimit në konvikt për bursën sipas kriterit ekonomik (pika 2.1/a) — zgjerim i bazës së përfituesve.
- b) Krijimi i pasqyrës së re nr. 2.1 me masë bursë specifike për arsimin profesional: 12,800 lekë/muaj (kundrejt 7,320 lekë aktualisht), rritje +74.9%.
- c) Rritja e numrit minimal të garantuar të bursave për arsimin profesional nga 2,500 në 5,000/vit, me 2,500 të dedikuara për hyrjet e reja (pika 29).
- d) Rishikimi i pasqyrës nr. 3 — kuota ushqimore ditore e konviktit rritet nga 222.3 lekë/ditë në 403 lekë/ditë (+81%), duke reflektuar indeksimin e çmimeve të ushqimeve.
- e) Rritja e masës së bursës për arsimin e përgjithshëm parauniversitar nga 7,320 lekë/muaj në 7,500 lekë/muaj (+2.5%).
- f) Mundësia për NjQV-të të ofrojnë shërbim ushqimi (pika 22/1) për nxënësit e klasave 1–5 dhe/ose 6–9, me kuotë 500 lekë/nxënës/ditë.
- g) Rritja e pragut ekonomik të Pasqyrës nr. 1 me +500 lekë/frymë/muaj për çdo kategori familjare, duke zgjeruar bazën e kualifikueshme.
- h) Indeksi automatik vjetor i bursave sipas IÇK-INSTAT, duke filluar nga viti 2027 (pika 30/1 e re).

Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet e masës mujore të bursës për çdo kategori nxënësish:

Kategoria	VKM ekzistues (lekë/muaj)	666 Draft i ri (lekë/muaj)	+/-	%
Sh. 9-vjeçare & e mesme — bursë e plotë	7,320	7,500	+180	+2.5%
Sh. Mieshtërisë Sportive & Arsimit Special	7,900	9,100	+1,200	+15.2%
Nxënës jetimë	7,900	9,000	+1,100	+13.9%
Arsim profesional — bursë e plotë (të gjitha kriteret)	7,320	12,800	+5,480	+74.9%
Arsim profesional — gjysmëbursë	3,660	6,400	+2,740	+74.9%
Kuotë mujore konvikt (×30 ditë + shpenz. vetjake)	7,319	12,740	+5,421	+74%

Kuota mujore e konviktit llogaritet si: kuotë ditore × 30 ditë + shpenzime vetjake. Sipas draft VKM: $403 \times 30 + 650 = 12,740$ lekë/muaj. Shpenzime vetjake: 650 lekë/muaj (pa ndryshim). Efekti vjetor 127.400 lek/bursist.

Llogaritja	Kosto shtesë/vit (lekë)	Kosto shtesë/vit (EUR)
------------	-------------------------	------------------------

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

A. MINISTERIA E ARSIMIT — Bursë parauniversitare (arsimi bazë)			
3,700 nxënës jashtë konviktit (rritje +180 lekë/muaj)	$3,700 \times 180 \times 10$	6 660 000	66 600
300 nxënës konvikt (rritje kuote +5,421 lekë/muaj)	$300 \times 5,421 \times 10$	16 263 000	162 630
~800 nxënës shtesë nga pragu i ri ekonomik (skenar. mesatar)	$800 \times 7,500 \times 10$	60 000 000	600 000
Nëntotali A — Ministria e Arsimit		82 923 000	829 230
B. MINISTERIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT — Bursë arsim profesional			
2,600 bursistë shtesë (nga 2,500 → 5,000 të garantuar)	$2,600 \times 12,800 \times 10$	332 800 000	3 328 000
2,400 bursistë ekzistues — rritje masë +5,480 lekë/muaj	$2,400 \times 5,480 \times 10$	131 520 000	1 315 200
Nëntotali B — Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit		464 320 000	4 643 200
C. NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE — Ushqim shkolla, klasat 1–5 (pika 22/1)			

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

~121,543 nxënës fillor publik (kl. 1–5) × 500 lekë/ditë × 175 ditë			
Skenari 10% (~12,154 nxënës)	$12,154 \times 500 \times 175$	1 063 475 000	10 634 750
Skenari 20% (~24,309 nxënës) skenari bazë	$24,309 \times 500 \times 175$	2 127 037 500	21 270 375
Skenari 30% (~36,463 nxënës)	$36,463 \times 500 \times 175$	3 190 512 500	31 905 125
Skenari 50% (~60,772 nxënës)	$60,772 \times 500 \times 175$	5 317 550 000	53 175 500
Skenari 100% — të gjithë nxënësit kl. 1–5	$121,543 \times 500 \times 175$	10 635 012 500	106 350 125

D. NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE — Ushqim shkolla, klasat 6–9 (pika 22/1)

Baza: ~100,657 nxënës publik (kl. 6–9) × 500 lekë/ditë × 175 ditë			
Skenari 10% (~10,066 nxënës)	$10,066 \times 500 \times 175$	880 775 000	8 807 750
Skenari 20% (~20,131 nxënës) skenari bazë	$20,131 \times 500 \times 175$	1 761 462 500	17 614 625
Skenari 50% (50,329 nxënës)	$50,329 \times 500 \times 175$	4 403 787 500	44 037 875

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”

Skenari 100% — të gjithë nxënësit kl. 6–9	100,657 × 500 × 175	8 807 487 500	88 074 875
PËRMBLEDHJE TOTALE			
Totali (A+B, pa pragu të ri dhe pa ushqim)		487 243 000	4 872 430
Totali A+B+C kl.1–5 sken. bazë 20%		2 674 280 500	26 742 805
Totali A+B+C+D kl.1–9 sken. bazë 20%		4 435 743 000	44 357 430

Supozime: 10 muaj pagese bursë; 175 ditë mësimore për ushqim; kursi 1 EUR = 100 lekë. Bursistë profesionalë aktualë: 2,400. Nxënës shtesë nga pragu i ri: 800 (skenari mesatar; varet nga densiteti familjar në brëzin 4,000–5,500 lekë/frymë/muaj).

Baza ushqim klasa. 1–5: 121,543 nxënës publik; klasa. 6–9: 100,657 nxënës publik

Impakti financiar nga indeksi.

Sipas pikës 30/1 të projektvendimit, bursat indeksohen çdo vit duke filluar nga viti 2027 sipas indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) të publikuar nga INSTAT. Duke përdorur normën e inflacionit aktual 2.6% (IÇK, mars 2026):

		Kosto totale pa indeksim	Kosto totale me indeksim 2.6%	Impakt inflacioni
Ministria Arsimit	e	375,720,000 lekë	385,489,000 lekë	+9,769,000 lekë (~97,687 EUR)
Ministria Ekonomisë dhe Inovacionit	e dhe	640,000,000 lekë	656,640,000 lekë	+16,640,000 lekë (~166,400 EUR)

Totali	1,015,720,000 lekë	1,042,129,000 lekë	+26,409,000 lekë (~264,087 EUR)
---------------	-----------------------	-----------------------	------------------------------------------------

Ndryshimet në masën e bursës dhe kuotave ushqimore, sipas tabelës 2.1 në arsimin e mesëm profesional, ku masa e bursës nga 7,320 lekë në muaj rritet në 12,800 lekë, sjellin këtë efekt financiar:

Bazuar në të dhënat historike mbi numrin e nxënësve të arsimit profesional që përfitojnë bursë, i vlerësuar maksimalisht në rreth 5,000 nxënës, kostoja vjetore për një periudhë prej 9 muajsh shkollë llogaritet në rreth 576 milionë lekë. Ky skenar përfaqëson një qasje gjithëpërfshirëse në mbështetjen financiare të nxënësve të AFP-së dhe ka një efekt financiar të konsiderueshëm në buxhetin vjetor të programit përkatës.

Aktualisht, kostoja për bursat në arsimin dhe formimin profesional vlerësohet në rreth 321 milionë lekë në vit. Në bazë të skenarit të propozuar, kostoja shtesë për vitin 2027 llogaritet në rreth 255 milionë lekë. Duke marrë në konsideratë faktin se vajzat në arsimin profesional përfitojnë gjysmëburse, kostoja shtesë efektive reduktohet dhe vlerësohet në rreth 196.6 milionë lekë.

Kjo kërkesë është parashikuar dhe paraqitur në kuadër të PBA 2027–2029, aktualisht në proces planifikimi, në Programin Buxhetor “Arsimi i Mesëm Profesional”, si një politikë e re, e argumentuar mbi bazën e çmimeve mesatare të vitit 2025 dhe nevojës për një mbështetje financiare më gjithëpërfshirëse për nxënësit e AFP-së.

Projektvendimi është parashikuar ti shtrijë efektet për vitin shkollor 2026-2027, duke filluar zbatimin e efekteve financiare për institucionet qendrore nga data 1 janar 2027, varësisht me buxhetin e ri në dispozicion.

PROPOZUESI

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI

PROPOZUESI

MINISTËR

DELINA IBRAHIMAJ

Mirela

Digitally signed by
Mirela Furxhi
Date: 2026.05.18

Delina

Digitally signed by
Delina Ibrahimaj
Date: 2026.05.18

Relacion shpjegues për projektvendimin për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar”